

Numri: KSC-BC-2020-07

Vendos: Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrësi Parashtrues: Hysni Gucati

Data: 29 shtator 2020

Gjuha: anglishte

Titulli i dosjes: *Prokurori i Specializuar k. Nasim Haradinajt dhe Hysni Gucati*

KLASIFIKIMI: Publike

PJESËMARRËSIT TË CILËVE DUHET T'U SHPËRNDAHET PARASHTRIMI:

Gjykatësit të Vetëm, ZPS-së, Kryetares së Dhomave të Specializuara, Mbrojtësit të Specializuar për z. Haradinaj

Kërkesë për Dorëzani

Zyra e Prokurorit të Specializuar
Valeria Boliçi (Valeria Bolici)

Mbrojtësi i Specializuar për z. Gucati
Xhonatan Elistan Ris (Jonathan Elystan Rees) QC

Bashkëmbrojtësi i Specializuar për z. Gucati
Valon Hasani

Kërkesë për Dorëzani

1. Pa paragjykim ndaj (1) kërkesës për kundërshtimin e ligjshmërisë së arrestimit në pajtim me nenin 41(2) të Ligjit Nr. 05/L-53 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), me arsyetim se fletarrestimi është lëshuar pa autoritet të ligjshëm, dhe (2) kërkesës për nxjerrjen e informacionit në lidhje me materialin në të cilin janë bazuar arrestimi dhe paraburgosja, parashtruesi, z. Gucati, paraqet kërkesë për dorëzani.

2. Neni 41(6) i Ligjit përcakton se paraburgimi urdhërohet vetëm kur ka arsye të arikulueshme për të besuar se:
 - i. ekziston rreziku i arratisjes;

 - ii. personi do të shkatërrojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë prova të krimit, ose rrethana konkrete tregojnë se do të pengojë kryerjen e procedimit penal duke ndikuar te dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryesit; ose

 - iii. pesha e krimit ose mënyra dhe rrethanat në të cilat është kryer dhe karakteristikat personale, sjellja e personit në të kaluarën, mjedisi dhe kushtet në të cilat personi jeton ose rrethana të tjera personale janë tregues të rrezikut se ai person do të përsërisë veprën penale, do të përfundojë një krim të tentuar ose do të kryejë një krim të cilin ka kërcënuar se do ta kryejë.

3. Neni 41(2) i Ligjit përcakton se Dhomat e Specializuara mund të urdhërojnë një varg masash, ndër të cilat dorëzanimin, kushtet e vendbanimit, duke përfshirë paraburgimin shtëpiak, ndalimin për t'iu afruar vendeve ose personave të

caktuar, dhe kushtet për paraqitje në stacione policore si alternativë e mbajtjes në paraburgim për të siguruar praninë, parandalimin e përsëritjes së krimit ose për të siguruar kryerjen e suksesshme të procedimit penal.

4. Si rrjedhojë, kur masat alternative u përgjigjen kushteve që përmban neni 41(6) i Ligjit, paraburgimi nuk mund të justifikohet më.
5. Në rastin konkret, dhe pa paragjykim ndaj (1) kërkesës për kundërshtimin e ligjshmërisë së arrestimit në pajtim me nenin 41(2) të Ligjit Nr. 05/L-53 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), me arsyetim se fletarrestimi është lëshuar pa autoritet të ligjshëm, dhe (2) kërkesës për nxjerrjen e informacionit në lidhje me materialin në të cilin janë bazuar arrestimi dhe paraburgosja, parashtuesi i kërkesës propozon dorëzani me këto kushte:
 - a. garanci në shumën prej 5,000 euro
 - b. dorëzimin e pasaportës së tij
 - c. kushtin që të jetojë dhe flejë çdo natë në shtëpinë e tij
 - d. paraqitje ditore në zyrat e policisë së EULEX-it
 - e. kushtin që të mos kontaktojë drejtpërdrejtë ose tërthorazi personat me të cilët gjykata konsideron se duhet të kufizohet kontakti
 - f. kushtin që të mos i afrohet më afër se 100 metra zyrave të Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

6. Këto kushte parandalojnë çdo rrezik të arratisjes, rrezikun se ai do të pengojë kryerjen e procedimit penal, ose të kryerjes së krimeve të tjera. Për me tepër, mbajtja e mëtejshme në paraburgim është masë shproporcionale në këto rrethana. Është e arsyeshme të kujtohet se:
- a. parashtruesi i kërkesës ka qenë bashkëpunues gjatë arrestimit;
 - b. parashtruesi i kërkesës nuk është akuzuar për asnjë shkelje, dhe mund të mos akuzohet kurrë;
 - c. shkeljet që po hetohen nuk duket se përfshijnë pretendime për përdorim të forcës;
 - d. shkeljet që po hetohen nuk duket se përfshijnë pretendime për përdorimin e kërcënimeve (ndryshe nga ekspozimi ndaj kërcënimeve të mundshme);
 - e. shkeljet që po hetohen nuk duket se përfshijnë pretendime për shkaktimin e dëmtimeve konkrete (ndryshe nga ekspozimi ndaj dëmtimeve të mundshme);
 - f. Maksimumi i dënimit me heqje lirie për veprën penale të cenimit të fshehtësisë së procedurave në rrethanat që pretendohen në fletarrestim është burgim 1-vjeçar;
 - g. Maksimumi i dënimit me heqje lirie për veprën penale të hakmarrjes në rrethanat që pretendohen në fletarrestim është burgim 3-vjeçar; dhe

- h. edhe pse maksimumi i dënimit me heqje lirie për veprën penale të frikësimit gjatë procedurave penale është 10 vjet (duke filluar nga më së paku dy vjet), dënimet më të gjata brenda spektrit të dënimeve duhet të jepen vetëm për rastet që përfshijnë përdorimin e forcës dhe kërcënimeve konkrete.

Numri i fjalëve (në origjinal): 632 fjalë

nënshkrimi

XHONATAN ELISTAN RIS QC

Mbrojtësi i Specializuar për parashtruesin e kërkesës

VALON HASANI

Bashkëmbrojtësi i Specializuar për parashtruesin e kërkesës: